

SHËRBIMET PËR FËMIJËRINË E HERSHME TË SESTO FIORENTINO-S

Shërbimet për fëmijërinë në këtë zonë, propozojnë një **ofertë edukative** që synon zhvillimin e plotë të fëmijëve dhe **mbështetjen për familjet** me fëmijë nga zero deri në tre vjeç; ato përbëjnë një sistem **mundësish edukative** që promovojnë, në **bashkëpunim** të ngushtë me familjet, zhvillimin harmonik e të plotë të kapaciteteve të fëmijëve të pranuar në këto shërbime.

Familjet mirëprehen si bashkëprotagonistë të projektit edukativ të shërbimeve, si prurës të vlerave dhe kulturave të tyre origjinale si dhe të të drejtave të informacionit, të pjesëmarrjes dhe të ndarjes së aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të këtyre shërbimeve.

Në kuadrin e shërbimeve edukative, respektohen të drejtat e individit, ato sociale dhe civile të qytetarëve më të vegjël dhe identifikohen veprimtari e ndërhyrje që synojnë t'u përgjigjen në mënyrë efektive nevojave të tyre.

Lloji i shërbimeve edukative në territorin e Komunës së Sesto Fiorentino-s: oferta publike - oferta private

Oferta publike: shërbimet komunale:

Emri	Tipologjia	Vendet nëçerdhe
ALICE	CERDHE ME KOHE TE PLOTE	61
Via XX Settembre, 217		
ELIO MARINI	CERDHE ME KOHE TE PLOTE	54
Via Tommaseo, 25/A		
GIANNI RODARI	CERDHE ME KOHE TE PLOTE	54
Via Gora, 40		
QUERCETO	CERDHE ME KOHE TE PLOTE	54
Via Venezia, 31		
IL GATTO E LA VOLPE	CERDHE ME KOHE TE PLOTE	35
Viale Togliatti, 225		
IL PENTOLINO MAGICO	CERDHE ME KOHE TE PJESSHME	25
Via XX Settembre, 217		
LA COCCINELLA	HAPESIRE LOJE PASDITE	18
Via XX Settembre, 217		

Për të marrë pjesë në këto shërbime, është e domosdoshme të paraqisni një kërkesë regjistrimi sipas procedurave dhe gjatë periudhave të përcaktuara dhe të komunikuara në faqen zyrtare të Komunës së Sesto Fiorentino-s, përafërsisht në muajin maj.

Formularët mund të dërgohen nëpërmjet internetit ose në Zyrën e Shërbimeve Edukative për fëmijët.

Në varësi të karakteristikave të familjeve kërkuese, përcaktohen pikët për secilën prej tyre; në bazë të pikëve të marra, përpilohen listat e pranimit.

Familjet pjesëmarrëse kontribuojnë pjesërisht për të mbuluar shpenzimet, duke paguar çdo muaj, një tarifë vjetore që përcaktohet në bazë të ISEE dhe sipas llojit të shërbimit dhe orarit të frekuentimit.

Kopshtet komunalë pranojnë fëmijët nga 3 muaj deri në 3 vjeç dhe janë të organizuar në grupe sipas moshës së fëmijës, mbi bazën e projektit pedagogjik/edukativ të shërbimit edukativ 0-3 vjeç, si më poshtë:

. Grupi "Të vegjël": pranon fëmijët nën moshën katërmëdhjetë muajshe të përfshira në listat Shumë të vegjël / Të vegjël A / Të vegjël B

. Grupi "Mesatarë": mirëpret fëmijët e moshës nga katërmëdhjetë deri në njëzet e tre muaj.

. Grupi "Të mëdhenj": pranon fëmijët e moshës nga njëzet e katër deri në tridhjetë e gjashtë muaj.

Hapësira e lojërave të pasdites pranon fëmijët nga 18 muajsh deri në tre vjeç dhe ofron mundësi për të bërë eksperience loje individuale dhe kolektive, me një frekuencë orare të reduktuar.

Ky shërbim përfshin një vakt të lehtë; është i hapur çdo pasdite, nga e hëna deri të premten, nga shtatori në qershor, në orarin: 15:00 - 19:30.

Hapja në muajin korrik do të bëhet në bazë të numrit të kërkesave të familjeve: minimumi 6/ maksimumi 10.

Oferta private: shërbime edukative drejtuar nga privatë të akredituar dhe në marrëveshje.

Janë shërbime të autorizuarra, të drejtuar nga shoqëri, kooperativa, institucione, shoqata ose ndërmarrje individuale, të organizuara në përputhje me normat rajonale të referimit.

Bashkia, autorizon, akrediton dhe monitoron funksionimin e tyre.

Subjekti drejtues, në zyrën e vet, garanton realizimin e projektit pedagogjik/edukativ të shërbimit përmes punonjësve të vet.

Regjistrimet menaxhohen direkt nga operatori privat; familjet paguajnë tarifën e përcaktuar nga subjekti privat, të treguara në "Kartën e Shërbimeve për Fëmijërinë e Hershme" dhe në rregulloren e brendshme të shërbimit.

Familjet e përfshira në listat komunale të pritjes që zgjedhin të frekuentojnë një shërbim të akredituar, kanë mundësinë të gëzojnë një rimbursim të pjesshëm të quajtur **bono shërbimi**.

Procedurat për dhënien e këtij përfitimi dhe financat e disponueshme janë të përcaktuara nga Njoftimi i Rajonit Toscana në varësi të burimeve në dispozicion të saj.

Bonoja e shërbimit u caktohet vetëm familjeve që gjenden në listën e pritjes në renditjen komunale pasi kanë bërë kërkesën për regjistrim sipas afatit dhe mënyrës së parashikuar në faqen zyrtare të Institucionit: është një kontribut rajonal për familjet e mospranuara në kopshtet komunale dhe të përfshira në listën e pritjes e që regjistrojnë drejtpërdrejt fëmijët e tyre në shërbimet private të akredituara 0/3 vjeç.

Projekti edukativ

Projekti edukativ përmbledh vlerat e referimit, qëllimet e përgjithshme dhe udhëzimet formuese që karakterizojnë shërbimin.

Vlerat e referimit të Shërbimit:

- ▶ fëmija si një person që zotëron të drejta
- ▶ familja si një subjekt prurës i një kulture të vet edukative
- ▶ edukatori si një profesionist me aftësi të veçanta
- ▶ dallimet si një element themelor i personave dhe konteksteve.

Objektivat e përgjithshme, duke marrë frymëzim nga vlerat e mësipërme, përshkruajnë rrugën edukative që duhet ndjekur dhe kanë për qëllim:

- të bashkëpunojnë me familjet në rritjen, edukimin dhe socializimin e fëmijëve që i janë besuar Shërbimit, duke promovuar mirëqënien psikofizike dhe zhvillimin e kapaciteteve të tyre të diturisë, emocionale, relacionale dhe sociale
- të parandalojnë dhe të ndërhyjnë në raste disavantazhi psiko-fizik dhe socio-kulturor
- të garantojnë shërbime profesionale të kualifikuara nga ana e personelit edukator, nëpërmjet trajnimeve dhe mbikëqyrjes së Koordinimit Pedagogjik
- të realizojnë vazhdimësinë edukative me familjen, me shërbimet e tjera për fëmijërinë e hershme dhe shkollën e fëmijës.
- të shpërndajnë informacion mbi problematikat që lidhen me fëmijërinë e hershme në mënyrë që të mirëpritën dhe të vlerësohen dallimet personale, sociale dhe kulturore

Shërbimet edukative private të akredituara e në marrëveshje

Disa shërbime private të akredituara, nëpërmjet marrëveshjeve, janë vënë në dispozicion të Komunës, duke rezervuar një pjesë të vendeve të tyre për fëmijët e përfshirë në listat komunale. Vendet për në çerdhe caktohen mbi bazën e pikëve të marra tek listat dhe nëse kërkohen nga vetë familjet.

Komuna merr përsipër të paguajë një pjesë të tarifës mujore.

Emri	Tipologjia	Vendet ne çerdhe
IL CAPPELLAIO MATTO Via Leopardi, 86	CERDHE	50
L'ALBERO DI JESSE Via Cino da Pistoia	CERDHE	30
SOLE – LUNA Via Brunelleschi, 2/4	CERDHE DHE HAPESIRE LOJE	19
SOTTO L'OMBRELLO DI MARY POPPINS Via Venni, 2/4	CERDHE	23

SANTA MARTA Via del Gavine 6	CERDHE	39
L'ARCOBALENA Via Garibaldi, 206	CERDHE	31
UN MONDO A FORMA DI ME Via del Trebbio, 60	CERDHE	33
BABYLANDIA Via Tommaseo, 21	CERDHE E HAPESIRE LOJE	23
ANACLETO Via Fibonacci, 29	SHERBIM EDUKATIV në KONTEKST SHTEPIAK	5

A. Pranimi në shërbim: kriteret dhe mënyrat e regjistrimit.

Kriteret dhe mënyrat e regjistrimit janë të përcaktuara në Planin Edukativ Komunal (PEK), i cili shkruhet çdo vit.

Në PEK tregohen:

- **Standardet e menaxhimit të shërbimeve, komunale dhe private të akredituara, për fëmijërinë e hershme.**
- **Kriteret në dhënien e pikëve**
- **Përcaktimi i kriterëve për marrëveshjet me administratorët e çerdheve private të fëmijës, të akredituara në territorin e Komunës së Sesto Fiorentino-s.**

Në shërbimet publike për fëmijërinë e hershme, janë miratuar kriteret pranimi të paracaktuara e publike, të cilat u japin përparësi rasteve të paaftësisë dhe disavantazhit social të çertifikuara nga shërbimet sociale territoriale.

Kërkesat e regjistrimit në shërbimet komunale për fëmijërinë e hershme dhe në vendet e rezervuara të çerdheve private të akredituara në zonë, duhet të dorëzohen brenda afatit dhe sipas mënyrës së përcaktuar në njoftimin përkatës.

Për të hyrë, fëmijët duhet të rezultojnë rezident në territorin komunal, së bashku me të paktën një prind ose kujdestar me autoritet prindëror, në datën e dorëzimit të aplikimit për regjistrim. Kërkesa për pranim mund të bëhet edhe për fëmijët **jo rezidentë** në Komunë.

Jorezidentët e përfshirë në listë, do të thirren vetëm pas përmbushjes së plotë të kërkesave për pranim të rezidentëve.

Ndër jorezidentët, do t'u jepet përparësi fëmijëve që jetojnë në Komunitat që bëjnë pjesë të Konferencës për Arsimin e Zonës Fiorentine Veri-Perëndimore.

B. Si informohen familjet në lidhje me regjistrimin dhe organizimin e shërbimit.

- Njoftimi do të reklamohet në faqen e internetit të Komunitës së Sesto Fiorentino-s dhe do të afishohet në hapësirat përkatëse.
- Në periudhën e publikimit të shpalljes, është e mundur të vizitohen shërbimet komunale për fëmijërinë e hershme – dita e hapjes (open day) - dhe private të akredituara në territor, sipas kalendarit dhe orarit të treguar në njoftim.
- Për familjet rezidente, është e mundur të bëhet regjistrimi në internet nëpërmjet kredencialeve të posaçme të hyrjes në sistem ose drejtpërsëdrejti, me ndihmën e operatorëve, në sportelin e zyrës së Shërbimit për fëmijët.
- Në përpilimin e listës së pranimit, do të përdoren si kritere për dhënien e pikëve:
 - përbërja e familjes dhe kushtet e punës së prindërve.
 - dokumentacioni i situatave të veçanta.

C. Përpunimi i listave të hyrjes dhe komunikimi i pranimit.

- Në bazë të kërkesave për pranim të marra, përpilohen **5 Lista prioritare** të ndara në grupe sipas moshës së fëmijëve: Shumë të vegjël, Të vegjël A, Të vegjël B, Të mesëm e Të mëdhenj.
- Listat prioritare në përgjithësi hartohen gjatë muajit qershor dhe mund të shihen në faqen institucionale në internet dhe në Zyrën e Shërbimeve për Fëmijërinë, në Via (Rruga) Gramsci numër 282.
- Caktimi i fëmijëve në shërbimin dhe orarin e përzgjedhur nga familja do të bëhet sipas renditjes të listat prioritare, duke iu referuar vendeve në dispozicion për çdo grupmoshë e duke marrë parasysh preferencat, maksimumi 12, në rradhë sipas rëndësisë, të shprehura nga ana e familjeve.
- Bashkë me pranimin, familjesi komunikohet dhe data e takimit të prindërve përdorues të rinj të shërbimit ku fëmija rezulton i pranuar.
- Për fëmijët me aftësi të kufizuara parashikohet prioritet në përfshirjen e tyre në Listat renditëse, sipas ligjit 104/92.
- Parashikohet gjithashtu një rezervim të vendeve, në Shërbimet komunale për fëmijërinë e hershme, për ata fëmijë, të identifikuar nga shërbimet sociale, në rrezik varfërie dhe vështirësi/rrezik social.

D. Kalendarit i hapjes dhe orari i Shërbimit

- Shërbimi zakonisht hap dyert të hënën e dytë të shtatorit dhe përfundon në javën e fundit të qershorit, me një ndërprerje për festat e Krishtlindjeve dhe Pashkëve, sipas kalendarit ministror, të miratuar me vendim të Këshillit të Rajonit të Toskanës. Kalendarit vjetor do t'u komunikohet familjeve.
- **Orari ditor i Shërbimit**
- Cerdhet komunale janë të hapura nga e hëna deri të premten në këto orare:
 - Alice (Liza), Querceto (Lisi i vogël), Rodari 7,30-13,30 7,30-16,00 7,30-17,30
 - Marini 7,30-13,30 7,30-16,00 7,30-17,30 8,00-18,00

- Il Gatto e la Volpe (Macja dhe Dhelpra) 7,30-14,00 7,30-16,00 7,30-17,30
- Il Pentolino Magico (Tigani i vogël Magjik) 7,30-14,00
- La Coccinella (Mollëkuqja) 15,00-19,30

E. Shërbimi i Ushqimit

- Cerdhetparashikojnë konsumimin edrekës nga të gjithë fëmijët e pranuar.
- Vaktet, mëngjesi, dreka dhe pasdreka sigurohen dhe shpërndahen në përputhje me rregulloren në fuqi.
- Që nga viti 1997, mensa shkollore në Komunën tonë menaxhohet nga kompania “Cilësi & Shërbime” Sh.A.
- Menutë përcaktohen nga dietistja e kompanisë, në përputhje me parimet ushqyese të përdoruesve të vegjël. Ushqimi që u jepet, i nënshtrohet kontrolleve të cilësisë të kryera si nga Zyra e Shërbimit Shkollor e Sportiv dhe Shërbimeve Edukative për fëmijët ashtu edhe prindërit testues të shijes të cilët bëjnë pjesë të Komisioni Mensa dhe Shijimi, prezent në çdo shërbim edukativ për fëmijërinë e hershme dhe në çdo shkollë të territorit.

F. Shëndeti

- Pjesëmarrja në shërbim u kërkon familjeve të respektojnë e të ndjekin udhëzimet higjieniko - sanitare të përcaktuara nga Agjenica Shëndetësore Lokale (ASL) për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqënien e fëmijëve dhe atyre që marrin pjesë në shërbim.

A. Ambientimi: çerdhja është një vend ndryshe nga shtëpia

Fazat fillestare të frekuentimit dhe ambientimit me çerdhen, kërkojnë që fëmija të ketë aftësinë për t'iu përshtatur një situate të re, e cila e çon atë të krijojë marrëdhënie të reja me të rritur dhe fëmijë të tjerë të ndryshëm nga personat familjarë.

Për të lehtësuar ambientimin e fëmijës është e nevojshme të sigurohet një proces që parashikon një kohë qendrimi gradual dhe përfshirjen e prindërve në fazën e parë të njohjes së çerdhes dhe edukatorëve të referimit.

Fëmija shoqërohet në çerdhe nga prindërit, në fillim për pak orë, pastaj për një gjysmë dite dhe vetëm kur fëmija është mësuar me situatën e re, pranohet për të gjithë ditën, sipas orarit të zgjedhur nga familja duke ndjekur pra një proces prej rreth tre javësh dhe që mund të ndryshojë, në varësi të nevojave të çdo fëmije.

B. Grupi i fëmijëve

Projekti organizativ parashikon nëndarjen e fëmijëve në tre grupe homogjene, secili prej tyre ka në dispozicion të rritur dhe njësi funksionale të referimit. Brenda çdo grupi, në organizimin e përditshëm të momenteve të ndryshme të ditës, parashikohet ndarja në grupe më të vegjël.

C. Organizimi i ditës: koha, rutinat, loja

Hipoteza organizative e ditës

Dita edukative alternohet me momente të kujdesit, lojës së lirë dhe lojës së strukturuar. Kalimi i kohës në çerdhe karakterizohet nga ngjarje që ripërsëriten çdo ditë në të njëjtën mënyrë e me vlerë të veçantë emocionale dhe afektive, në të cilin fëmija njih dhe gjen aspektet familjare të jetës së përditshme në një dimension të aktivitetit shoqëror të zgjeruar e të përbashkët.

Mirpritja dhe ribashkimi

Janë faza emocionalisht të ndjeshme që karakterizojnë fillimin dhe mbarimin e ditës së fëmijës në çerdhe, gjatë së cilës përjeton eksperiencë të ndarjes dhe ribashkimit me prindërit e tij dhe anasjelltas, ribashkimit dhe ndarjes me edukatorët e referimit.

Vakti i mëngjesit me fruta sezonale: është një moment që tregon përfundimin e fazës së mirpritjes, një hapësirë në të cilën formohet grupi i fëmijëve dhe ku çdo fëmijë sheh vetveten si anëtar të tij.

Momenti i ndërrimit dhe higjienës personale përsëritet shpesh gjatë ditës në orare të caktuara, si për shembull larja e duarve para dhe pas drekës. Ndërrimi është një moment marrëdhënieje e privilegjuar midis edukatorit dhe fëmijës, ku përfshihen përkëdheljet, gjestet e personalizuara dhe praktikat e përditshme: nëpërmjet përfshirjes aktive të fëmijës nxitet dhe mbështetet procesi i rritjes së tij drejt autonomisë.

Propozime edukative

Loja së bashku me fëmijët e tjerë është një nga eksperiencat më të rëndësishme për zhvillimin e diturisë dhe emocionit, e dobishme për të fituar aftësi dhe gjithashtu për të ndërtuar identitetin e vet; loja së bashku nënkupton edhe përballimin e problemeve dhe konflikteve, eksperimentimin e strategjive të përafritit dhe zhvillimin e inteligjencës sociale.

Edukatori propozon aktivitete të ndryshme në grupe të vogla fëmijësh, duke u siguruar atyre hapësirë dhe materiale.

Dreka, në ato shërbime ku parashikohet, është një situatë grumbullimi të madh social, ku përveç ndarjes së kënaqësisë së të ngrënit, ndahet edhe kënaqësia e të qenit bashkë me të rritur e fëmijë të tjerë.

Dreka është një situatë e vërtetë dhe e mirëfilltë e të mësuarit: fëmija gradualisht mëson të vetëushqehet si dhe rregullat e sjelljes shoqërore.

Gjumi është një moment emocionalisht i rëndësishëm: rënia në gjumë në mënyrë të qetë e të relaksuar nënkupton një marrëdhënie të fortë të besimit mes fëmijës dhe të rriturit që kujdeset për të.

Rregullsia e orareve dhe qetësia e mjedisit dhe përgjegjësit, ndihmojnë fëmijën të bjerë në gjumë në mënyrë paqësore.

Vakti i vogël

Pas gjumit të pasdites, vakti i vogël është një moment kur grupi rigjendet sërisht bashkë dhe i jep fillim sërish e në mënyrë të këndshme, pjesësisht fundit të ditës në çerdhe.

Në Hapësirën e Lojës, vakti i vogël, përveç vlerës së shoqërimit me fëmijët e tjerë, shënon dhe fillimin e aktiviteteve të lojës së strukturuar.

Për shembull:

Orari	Aktivitete
7.30-9.30	<i>Mikpritja (lojë e lirë)</i>
9.30-10.00	<i>Rrethi i përshëndetjes dhe mëngjes me fruta</i>
10.00-10.15	<i>Ndërrimi dhe higjiena personale (në grupe të vegjël)</i>
10.15-11.15	<i>Aktivitete të strukturuar (në grupe të vegjël)</i>
11.15-11.30	<i>Higjiena personale dhe përgatitja për drekë(në grupe të vegjël)</i>
11.30-12.15	<i>Drekë</i>
12.15-13.00	<i>Ndërrimi dhe higjiena personale (në grupe të vegjël)</i>
13.00-15.15	<i>Clodhja dhe pushimi</i>
15.15-16.00	<i>Ndërrimi - higjiena personale dhe vakti i vogël</i>
16.00	<i>Ribashkimi</i>
16.00-17.30	<i>Qendrim shtesë i mundshëm dhe më pas ribashkimi</i>